



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2423/7 prot.

Datë 22.11.2023

V E N D I M
Nr. 1215/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.11.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “M.Lezha” SHPK dhe “Murati-D” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-79080-09-06-2023 me objekt: “Blerje pajisje mobilerie, Shkolla fillore ”Myrteza Sala” Bilisht, Devoll”, me fond limit 4,298,177 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Klame” SHPK me NIPT K21518003F dhe adresë: Njesia Administrative Nr. 11, Koder Kamëz, Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati I, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Devoll
Lagjia Nr. 1, Rruga “24 Tetori” Nr.9, Bilisht, Devoll

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Murati D” SHPK, me NIPT K42003004T dhe adresë: Rruga e Kavajës, Ish- Kombinati Ushqimor, Godinë 1- katëshe, Tiranë.

Operatori ekonomik M.Lezha” SHPK me NIPT J76504013C dhe adresë Zona Industriale, Rruga Levizja e Postribës, nr pasurie 11/200, Zona Kadastrale 8592, Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.09.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79080-09-06-2023 me objekt: “Blerje pajisje mobilerie, Shkolla fillore ”Myrteza Sala” Bilisht, Devoll”, me fond limit 4,298,177 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

II.2. Në datë 18.09.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 21.09.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “M.Lezha” SHPK	2,833,900	lekë	kualifikuar
2. “RO-AL” SHPK	3,647,250	lekë	kualifikuar
3. “Bolt” SHPK	4,067,400	lekë	kualifikuar
4. “BUNA” SHPK	pa ofertë ekonomike		skualifikuar
5. “Emko” SHPK	3,853,900	lekë	kualifikuar
6. “Erald ” SHPK	3,096,700	lekë	skualifikuar
7. “Erzeni/Sh” SHPK	3,679,500	lekë	kualifikuar
8. “Eurocomerc” SHPK	3,923,100	lekë	kualifikuar
9. “Ilir Kaso” PF	3,574,256	lekë	skualifikuar
10. “Klame” SHPK	3.644.600	lekë	kualifikuar
11. “Muca” SHPK	4.054.100	lekë	kualifikuar
12. “Murati D” SHPK	3.607.300	lekë	kualifikuar
13. “NEF COMPANY-RF” SHPK	4.089.900	lekë	kualifikuar
14. “Shaga” SHPK	3.861.890	lekë	kualifikuar

II.6. Në datën 28.09.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Në datën 03.10.2023, në mënyrë shkresore pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. protokoli 2423/2023, datë 03.10.2023,

e operatorit ekonomik "Klame" SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë "M.Lezha" SHPK dhe "Murati-D" SHPK e më konkretisht:

[...] Ne datën 28.09.2023, më së pari dijeni nëpërmjet SPE për shpalljen e fituesit <https://ëëë.app.gov.al/njoftimi-i-fituesit/> të Operatorit "M/Lezha" shpk.

Nga sa më sipër del qartë se oferta ekonomike e shoqërisë M Lezha është Anomalisht e ulët. Kjo shoqëri nuk ka arritur dot të vërtetojë me shkresë dhe analizë të detajuar tekniko-financiare të argumentojë se me këto oferte ka mundësi të realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi.

I. Autoriteti kontraktor ka shkelur rregullat e prokurimit publik kur ka kualifikuar operatorin ekonomik "M Lezha" Sh.p.k.

1. E kundërshtojmë këtë renditje në klasifikimin e ofertave të bërë nga AK pasi operatori ekonomik "M. Lezha" Sh.p.k është kualifikuar në mënyrë abusive, të padrejtë dhe në kundërshtim me LPP. Në rastin konkret të këtij prokurimi kemi të bëjmë me 11 oferta të cilat janë konsideruar të vlefshme nga KVO, ndërkohë që oferta e ofruar nga "M. Lezha" Sh.p.k është me vlerë të ulur më shumë se 85% të mesatares se ofertave të kualifikuara.

2. Në nenin 82 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikon se: "4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogarit; - Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së. [...]"

3. Nga shqyrtimi i informacionit të kufizuar të dhënë nga autoriteti kontraktor në SPE pasi në Formularin e Njoftimit të Fituesit Paraprak mungon totalisht informacioni, rezulton se nga ana e A-K specifikohet në mënyrë të varfër duke mos i dhënë operatoreve të tjere të kualifikuara asnjë informacion apo dokumentacion sesi është proceduar nga fillimi deri në fund me ofertën anomalisht të ulët por është mjaftuar vetëm me përshkrimin: "PROCES VERBAL mbi vlerësimin e pranuar të ofertës anomalisht të ulët -I mbajtur me datë 20.09.2023 nga KVO për procedurën e prokurimit me objekt, "Blerje p Devoll", REF- 79080-09-06-2023, zhv."

4. E gjithë kjo perben shkelje të plote të Nenit 93 të Ligjit nr.162, datë 13.12.2020 "Ligji i Prokurimeve Publike", i ndryshuar, i cili ka parashikuar se: "1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i

kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; c) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore. 3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni. Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera. 4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi. [...]"

5. Nga interpretimi literal i dispozitave ligjore të referuara me sipër, konstatojmë se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Anomalisht e Ulet.

6. Gjithashtu, gjykojmë se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për të dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor.

7. Si fillim, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve.

8. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

9. Shoqëria jone gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët.

10. Referuar dispozitave ligjore të referuara me sipër, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur.

11. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

12. Shoqëria jone gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. Theksojme se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit apo furnizimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

13. Gjithashtu, theksojme se referuar nenit 2 gërma "a" dhe "b" "Qëllimi" i ligjit nr.162, datë 13.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;."

14. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar "çmimit më të ulët"), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijjnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.

15. Ligjëvendësi ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulta të cilat në çdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rrezik për realizimin me sukses të kontratës me çmimin e ofertuar dhe se në këtë çmim janë të përfshira të gjithë elementët e koston të nevojshme dhe të detyrueshme për tu mbuluar. Në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 93 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se përmbushin 4 kushtet kumulative ku dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar në Vendim të Këshillit të Ministrave.

16. Në rastin konkret shoqëria "M. Lezha" Sh.p.k nuk duket që te kete paraqitur ndonje dokumentacion e jo me te kete permbushur ne menyre kumulative kerkesat e ligjit. Pra, jemi perpara atyre rasteve kur nuk kemi asnje argumentim te plote I cili te krijon bindjen për realizimin me sukses të kontratës objekt ankimi. Konkretisht operatori ekonomik nuk duket te kete te kete paraqitur një përshkrimi/analize te detajuar të detajuar të koston në formë tabelare për furnizimin dhe vendosjen e mallrave që do të realizohen nga operatori ekonomik duke mos krijuar kështu bindjen se operatori ekonomik ka aftësi për të realizuar me sukses kontraten objekt prokurimi.

17. Sa më sipër, gjykojme se nga ana e operatorit ekonomik - oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion i plotë që argumenton ofertën anomalisht të ulët, duke krijuar bindjer se kjo

ofertë është e parregullt në të gjithë elementët e saj dhe nuk garanton një kontratë të suksesshme.

Ne keto kushte, kërkojmë anulimin e vendimit për kualifikimin e operatorit të referuar më sipër.

II. Kërkojmë skualifikimin e shoqërisë "Murati D" Sh.p.k, si shoqëri që nuk i përmbush kërkesat e kualifikimit. Konkretisht:

1. Referuar Kriteretë të PËRGGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT, gërmes a), rezultoni të jete kërkuar: "Ofertuesi deklaron se: a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;"

2. Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-se, mbi lejet që ka të leshuara nga Institucionet Shtetërore Publike ky operator, rezultoni se e vetmja leje që disponon nuk ka asnjë lidhje me objektin e prokurimit/fushën e veprimtarisë që ka të bëjë me Mobilimin/Perpunimin e Drurit etj.

3. Konkretisht, leja që ka kjo shoqëri është ajo e datës 27.10.2014, leshuar nga Ministria e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Mjedisit e cila ka pajisur Personin Juridik "Murati D" Sh.p.k, Nipt: K42003004T, me Leje (LC-8014-15-10-2014), me Titull: "Magazinin i Kimikateve", Përshkrim Veprimtarie dhe Kapacitet Prodhues: "Magazinin I Kimikateve" me kapacitet të projektuar 30.000 litra në muaj.

4. Sa për të ilustruar pretendimet tona, bëjmë me dije se shoqëria jone që operon në fushën e perpunimit të drurit dhe mobilimit etj, dhe që ka deklaruar një gjë të tillë në Shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës I Deklarimit", është e pajisur me:

- Leje Nr: PN-5357-04-2013, date 25/04/2013, me objekt: "Fabrikë përpunimi druri, mobileri, tapiceri".
- Leje Nr: PN-4578-02-2017, date 01/02/2017, me objekt: "nënshtrës ose që bën tharjen, ose kujdeset pas këtyre aplikimeve, stampon me bojë ose ngjyros ose aplikon çdo material tjetër veshës si një veprimtari prodhimi ose gjatë veprimtarisë së prodhimit".
- Leje Nr: PN-1180-05-2022, date 09.05.2022 me objekt: "Prodhimi i produkteve të perbera teresisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, ferkimin me rere, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit dhe Veprimtari të lyerjes/veshjes të aplikuar në sipërfaqe druri.

5. Nga sa më sipër, nuk mjafton që një operator ekonomik të bëjë një deklaram vullnetar në QKB dhe të konsiderohet se ai ushtron veprimtari në fushën e objektit të këtij prokurimi.

6. Legjislacioni ka parapare kushte për të patur mundësi ligjrisht të ushtrosh aktivitet në fushën e prokurimit. Është ministria përkatese e linjës dhe Agjencite vartëse e tyre që bëjnë shqyrtimin e kërkesave të shoqërive që janë të interesuara në këto fushë dhe më pas nëse këto të fundit i përmbushin kërkesat ligjore i pajisin ato me Leje përkatese që i lejon ato të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e perpunimit të drurit dhe mobilimit etj.

Ne keto kushte, shoqeria e referuar me siper "Murati D" Sh.pk, nuk eshte e licencuar/lejuar ligjerisht te ushtroje aktivitet ne fushen e veprimtarise objekt prokurimi, per rrjedhoje duhet te skualifikohet.

1. Gjithashtu, kerkojme skualifikimin e shoqerise "Murati D" Sh.p.k pasi nuk permbush kerkesen kualifikuese te percaktuar ne piken 2.3.1. ku eshte percaktuar:

"2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të kontrates,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Operatori ekonomik nuk ka arritur te provoje me ane te dokumentacionit te referuar me siper se ka përvojë te mëparshme sipas objektit te prokurimit.

Per kete arsye, kerkojme anullimin e vendimit qe kualifikon kete shoqeri.

Nga sa parashtruam dhe analizuam me siper, kerkojme:

Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e plote te ankeses;

Pranimin teresisht te ankeses sipas parashtrimeve te referuara me siper.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 2423/2 date 04.10.2023, duke referuar kriteret e kualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “Klame” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga secili prej operatorëve ekonomikë “ M.Lezha” SHPK, dhe “Murati D” SHPK, pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

II.9. Me shkresën nr. 3114/4 prot, datë 11.10.2023 me objekt: “Dërgim vendimi”, protokolluar me tonën me nr.2423/3 datë 13.10.2023, nga autoriteti kontraktor është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion në lidhje me procedurën e prokurimit si dhe akti i trajtimit të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Klame” SHPK, vendimi nr.01 datë 10.10.2023 i

Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, sipas të cilit është vendosur refuzimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Me shkresën nr. 2423/4 prot, datë 02.11.2023, me objekt: “Vënie në dijeni”, Komisioni Prokurimit Publik iu drejtua Autoritetit Kontraktor, Operatorit Ekonomik Ankimues dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, duke i informuar, se Komisioni Prokurimit Publik referuar nenit 115, pika 5 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ju bën të ditur të gjitha palëve të mësipërme, se Komisioni Prokurimit Publik ka kërkuar informacion shtesë verifikim nga palë të treta (institucione shtetërore), dhe në referim të dispozitave të sipërcituara afatet për shqyrtimin e ankesës nr. 2423 prot, datë 03.10.2023 do të ndërpriten deri në mbërritjen e informacionit.

II.11. Me shkresën nr. 2423/5 prot, datë 02.11.2023, me objekt: “Kërkesë për informacion”, Komisioni Prokurimit Publik iu drejtua Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve, duke kërkuar informacion me përmbajtje si vijon:

Në kuptim e zbatim të nenit 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.

Në kuadër të shqyrtimit të një ankese, gjatë veprimtarisë tonë, lind e nevojshme ndihma juaj, nëpërmjet informacionit përsa i përket të një fature tatimore shitje. Konkretisht kërkojmë të verifikojmë:

- *A është deklaruar fatura tatimore e shitjes me Nr. serie 79960311 dhe Nr. fature 311 (bashkëngjitur), nga ana e subjektit “Murati D” SHPK?*
- *Nëse po, në cilën datë është deklaruar?*

II.12. Me shkresën nr.17624/1 prot., datë 17.11.2023, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2423/6 prot, datë 20.11.2023 me objekt: “Kthim përgjigje”, Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve ka dërguar informacionin me përmbajtjen si më poshtë:

Në përgjigje të shkresës suaj me nr.2423/5 Prot, datë 02.11.2023, protokolluar me tonën nr. 17624 Prot., datë 06.11.2023, nëpërmjet së cilës kërkon informacion lidhur me faturën tatimore të shitjes të tatimpaguesit "Murati D" shpk, ju konfirmojmë se:

Fatura tatimore e "Murati D" shpk, nr.311, datë 01.09.2020, serial 79960311, është deklaruar në librin e shitjes së periudhës shtator 2020.

II.13. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit

Prokurimit Publik nuk është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Klame” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Murati D” SHPK me arsyetimin se: “[...] *Referuar Kriteve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, gërma a), rezulton te jete kerkuar: "Ofertuesi deklaron se: a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;"*

2. *Nga verifikimi ne faqen zyrtare te QKB-se, mbi lejet qe ka te leshuara nga Institucionet Shteterore Publike ky operator, rezulton se e vetmja leje qe disponon nuk ka asnje lidhje me objektin e prokurimit/fushen e veprimtarise qe ka te beje me Mobilimin/Perpunimin e Drurit etj. ...5. Nga sa me siper, nuk mjafton qe nje operator ekonomik te beje nje deklarim vullnetar ne QKB dhe te konsiderohet se ai ushtron veprimtari ne fushen e objektit te ketij prokurimi. ...Ne keto kushte, shoqeria e referuar me siper "Murati D" Sh.pk, nuk eshte e licencuar/lejuar ligjerisht te ushtroje aktivitet ne fushen e veprimtarise objekt prokurimi, per rrjedhoje duhet te skualifikohet. .” [...] Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “a” e dokumentare të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; [...]

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

III.1.2. Në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit , në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<i>Deklarata</i>
<i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>

III.1.3. Nga verifikimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik , konstatohet se operatori ekonomik “Murati D” SHPK ka dorëzuar:

1. Shtojca 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, ku në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” është deklaruar si vijon:

“Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme - sipas QKB dhe statusit aktiv – Ekstrakt i thjesht”

III.1.4. Në Nenin 77, pika 1 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.5. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për sa i përket objektit të veprimtarisë së shoqërisë “Murati D” SHPK, KPP gjykon se kriteri në lidhje me objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues, në përputhje me objektin e procedurës objekt ankimi, është një kërkesë e cila bën pjesë tek kriteret e përgjithshme të kualifikimit, ku referuar përcaktimeve në dokumentat e tenderit këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK rezulton se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, “*Shkaqet e përjashtimit*”, gërma “A” “*Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit*”, ky i fundit ka deklaruar: “*Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.*”

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme - sipas QKB dhe statusit aktiv – Ekstrakt i thjesht”.

Gjithashtu, nga verifikimi i Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Murati D” SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se objekti i aktivitetit të shoqërisë “Murati D” SHPK është përcaktuar: “*Tregetim imp-eks me shumice e pakice te mallrave ushqimor, buqesor, automjetesh te cdo lloji, Hapje lavazhi e servisi, tregetim*

bime medicinale, tregetim plerash kimik, hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, bar-restoranti, shtypshkrime, kancelari, sherbime telefonike. Ngritje linjash telefonike, investime ne ndertim, energjitik, tregetim dhe transport te lendes drusore, transport udhetaresh dhe mallrash. Tregtim shkumesi, pajisje didaktike e laboratorike per shkolla. Prodhim shkumesi, veshembathje, mobilje zyre, tregtim materjale elektrike, hidraulike e kondicionere. prodhim e tregtim mobiljesh, tregtim te artikujve ndertimor, tregtim kompjuterash e fonie e perberes te tyre si dhe sherbimet perkatese. Tregtim prodhim importim te detergjenteve, klorit dhe materialeve plastike e ato te pastrimit. Furnizim e vendosje perde per zyra. Sherbim mirembajtje, sherbim pastrimi, sherbime rikonstruksione ndertimi dhe lysterje. Tregtim me shumice e pakice te sobave te ndryshme si edhe paisjet e tyre. Kategoria: Sherbime te tjera shendetesore dhe higjeno sanitare. Nenkategoria: Sherbime te ndryshme higjeno sanitare. Kodi II&B. Kategoria: per ndikimin ne Mjedis. Nenkategoria: nenkategoria Leje Mjedisore e tipit C, Kodi III.1.A. Tregtim te artikujve per Covid-19 si doreza nje perdorimshe maska dizifektues, kostum dizifektimi solucion dizifektimi si dizifektues ambjenti dhe duarsh etj... Sherbim dizifektimi me te gjitha paisjet dhe dizifektantet perkates. Blerje pjese mekanike metalike guzhineta. Blerje pelet. Blerje materiale te buta te te gjitha lloit.”

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, ku deklarohet se ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, si dhe në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “Murati D” SHPK, sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar si më sipër cituar rezulton se përfshihet objekti i prokurimit.

III.1.7. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se “Nga sa më sipër, nuk mjafton që një operator ekonomik të bëjë një deklaram vullnetar në QKB dhe të konsiderohet se ai ushtron veprimtari në fushën e objektit të këtij prokurimi. Legjislacioni ka paraparë kushte plotësimi I të cilave është detyruar për secilin operator ekonomik që dëshiron të ushtrojë aktivitet në fushën objekt prokurimi. Është ministria përkatëse e linjës dhe Agjencitë vartëse e tyre që bëjnë shqyrtimin e kërkesave të shoqëive që janë të interesuara në këtë fushë dhe më pas nëse këto të fundit I përmbushin kërkesat ligjore I pajisin ato me Leje përkatëse që I lejon ato të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e përpunimit të drurit dhe mobilimit etj. Në këto kushte, shoqëria e referuar më sipër “Murati D” shpk, nuk është e licensuar/lejuar ligjërisht të ushtrojë aktivitet në fushën e veprimtarisë objekt prokurimi, për rrjedhojë duhet të skualifikohet”, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në ofertën e tij “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” ku në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, gërma “A” “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ky i fundit ka deklaruar: “Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku

ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme - sipas QKB dhe statusit aktiv – Ekstrakt i thjeshtë”.

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit sikurse përmendëm edhe më sipër, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar në asnjë moment që të paraqitet ndonjë dokument shtesë që provon se operatori ekonomik ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit të procedurës konkrete. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit të paraqesin dokumenta shtesë apo licenca që vërtetojnë se ka objekt veprimtarie objektin e procedurës së prokurimit, por ligjvënësi ka parashikuar se objekti i veprimtarisë është një kusht ligjor që përcakohet në kriteret e përgjithshme dhe do të konsiderohet i përmbushur me “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit”. Ku, akoma më tej nga verifikimi në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Murati D” SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se “Murati D” SHPK ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cenon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk qëndrojnë

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Klame” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Murati D” SHPK me arsyetimin se: “[...] Gjithashtu, kerkojme skualifikimin e shoqerise "Murati D" Sh.p.k pasi nuk permbush kerkesen kualifikuese te percaktuar ne piken 2.3.1. ku eshte percaktuar:

"2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për pervojen e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të kontrates,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në

fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Operatori ekonomik nuk ka arritur të provojë me ane të dokumentacionit të referuar me sipër se ka përvijë të mëparshme sipas objektit të prokurimit.

Per kete arsye, kerkojme anullimin e vendimit qe kualifikon kete shoqeri“ [...] Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.2. Në dokumentet e tenderit, shtojca 7/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1., “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvijën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës ,*

Për të vërtetuar përvijën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *për përvijën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

b) *për përvijën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, operatori ekonomik “Murati D” SHPK., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë:

1. *Vërtetim nr.1881 prot., datë 12.03.2023 “Për realizim kontrate”, lëshuar nga Bashkia Kurbin*
 - *Kontrata nr.3247/15 prot., datë 26.08.2020, lidhur mes autoritetit kontraktor Bashkia Kurbin dhe operatorit ekonomik Murati-D SHPK, me objekt “Blerje mobilje për çerdhen, Bashkia Kurbin” dhe vlerë 2.848.720 lekë pa tvsh*
 - *Faturë tatimore shitje, nr.311, datë .09.2020, serial 79960311 me blerës Baskia Kurbin*
2. *Faturë tatimore nr.51/2022 datë 26.10.2022 me blerës Agjencia e Industrisë Kreative, Bashkia Tiranë.*

Duke marrë shkas nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Murati-D” SHPK, për mospërmbushje të kriterit 2.3.1 të dokumentave të tenderit, Komisioni Prokurimit Publik e gjykoi të arsyeshme verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Murati -D” SHPK për sa i përket *Faturës tatimore të shitjes, nr.311, datë .09.2020, serial 79960311*. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve me shkresën nr. 2423/5 prot., datë 02.11.2023 informacion lidhur me *faturën tatimore të shitjes shitjee më konkretish i kërkoi informacion nëse ishte deklaruar fatura tatimore e shitjes me Nr. serie 79960311 dhe Nr. fature 311(bashkëngjitur), nga ana e subjektit “Murati D” SHPK dhe nëse po datën në ë cilën ishte deklaruar*. Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 17624/1prot., datë 17.11.2023, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 2423/6 prot, datë 20.11.2023, ku ndër të tjera shprehet se: “ [...] *Fatura tatimore e "Murati D" shpk, nr.311, datë 01.09.2020, serial 79960311, është deklaruar në librin e shitjes së periudhës shtator 2020.*

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.2.5. Neni 40 pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor 26 përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë për të fituar kontratën publike në vlerën 20% të fondit limit të kësaj kontrate, të realizuar gjatë gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Murati-D” SHPK, konstatohet, se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur, dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.2.3. të këtij vendimi. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK, për mospërmbushjen e kriterit për vërtetimin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit të përcaktuar në “Kriteret e veçanta” të kualifikimit, “Aftësitë teknike dhe profesionale” pika 2.3.1 të dokumenteve të tenderit, nga operatori ekonomik “Murati-D” SHPK, nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ky i fundit në lidhje me furnizimet e ngjashme, KPP konstaton, se: Dokumentacionin i paraqitur nga operatori ekonomik “Murati-D” SHPK *Vërtetim nr.1881 prot., datë 12.03.2023 “Për realizim kontrate”, lëshuar nga Bashkia Kurbin*

- *Kontrata nr.3247/15 prot., datë 26.08.2020, lidhur mes autoritetit kontraktor Bashkia Kurbin dhe operatorit ekonomik Murati-D SHPK, me objekt “Blerje mobilje për çerdhen, Bashkia Kurbin” dhe vlerë 2.848.720 lekë pa tvsh*
- *Faturë tatimore shitje, nr.311, datë .09.2020, serial 79960311 me blerës Bashkia Kurbin*

nuk plotëson kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se për plotësimin e këtij kriteri nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësohet jo vetëm vlera e furnizimeve të ngjashme në masën 20% të vlerës së fondit limit të kontrates, por koha e kryerjes së këtyre furnizimeve duhet të jetë gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **(07.09.2023)** KPP konstaton se *Fatura tatimore e shitje, nr.311, datë 01.09.2020, serial 79960311*, paraqitur nga operatori ekonomik “Murati-D” SHPK, është lëshuar tej afatit 3 vjecar të parashikuar në pikën 2.3.1 të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, për rrjedhojë nuk provon përmbushjen e kriterit 2.3.1. të dokumentave standarde të tenderit.

Sa i përket dokumentacionit tjetër të dorëzuar nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK, në përmbushje të këtij kriteri, *Faturë tatimore nr.51/2022 datë 26.10.2022 me blerës Agjencia e Industrisë Kreative, Bashkia Tiranë*, Komisioni konstaton se kjo faturë është lëshuar me blerës Agjencia e Industrisë Kreative, Bashkia Tiranë. Referuar kriterit të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, nga operatori ekonomik në funksion të përmbushjes së këtij kriteri duhet të paraqitet përveç faturës edhe vërtetim i lëshuar nga enti publik. Në rastin konkret operatori ekonomik nuk ka bashkëngjitur një vërtetim të tillë. Sa më*

sipër, KPP gjykon se edhe ky dokumentacion nuk vërteton përmbushjen e kriterit të kërkuar nga autoriteti kontaktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Klame” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “M Lezha” SHPK me arsyetimin se: “[...] Autoriteti kontraktor ka shkelur rregullat e prokurimit publik kur ka kualifikuar operatorin ekonomik “M Lezha” Sh.p.k.

1.E kundërshtojmë këtë renditje në klasifikimin e ofertave të bërë nga AK pasi operatori ekonomik “M. Lezha” Sh.p.k është kualifikuar në mënyrë abusive, të padrejtë dhe në kundërshtim me LPP. Në rastin konkret të këtij prokurimi kemi të bëjmë me 11 oferta të cilat janë konsideruar të vlefshme nga KVO, ndërkohë që oferta e ofruar nga “M. Lezha” Sh.p.k është me vlerë të ulur më shumë se 85% të mesatares se ofertave të kualifikuara. ...

Sa më sipër, gjykojme se nga ana e operatorit ekonomik - oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion i plotë që argumenton ofertën anomalisht të ulët, duke krijuar bindje se kjo ofertë është e parregullt në të gjithë elementët e saj dhe nuk garanton një kontratë të suksesshme. Ne keto kushte, kërkojme anulimin e vendimit për kualifikimin e operatorit të referuar me sipër”,

Komisioni i Prokurimit Publik Konstaton se,

III.3.1.Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave ka konstatuar, se oferta e OE “M Lezha” SHPK është anomalisht e ulët. Në këto kushte KVO nëpërmjet seksionit “Kërkesa” të sistemit të prokurimeve elektronike, i është drejtuar operatorit ekonomik me kërkesë për sqarim/argumentim oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së: *“I mbajtur me date 18.09.2023 nga KVO per procedure e prokurimit Shkolla fillore “Myrteza Sala” Bilisht, Devoll”, REF-79080-09-06-2023, nga AK Bashkia Devoll, mbi vlerësimin e ofertes anomalisht të ulët. -KVO kontrolloi ofertat e paraqitura, kemi rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85 %e mesatares së ofertave të vlefshme. -KVO vëren se oferta e OE - “M. LEZHA” SHPK është anomalisht e ulët, i kërkojmë OE të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së”.*

III.3.2. Në përgjigje të kërkesës së KVO më datë 20.09.2023, AK vihet në dijeni nga operatori ekonomik “M.Lezha” SHPK me mesazhin dërguar në SPE në seksionin “Kërkesa” me përmbajtje: *Përshëndetje! Bashkëlidhur gjeni përgjigjen e kërkesës Tuaj. Ju faleminderit!*

III.3.3. Referuar Informacionit të Autoriteti Kontraktor dhe verifikimit në SPE rezulton se operatori ekonomik “M.Lezha” SHPK në mesazhin e dërguar në SPE ka bashkëngjitur

dokumentin e datës 20.09.2023, me objekt: “Kthim përgjigje në lidhje me ofertën anomalisht të ulët të shoqërisë M.Lezha shpk” me përmbajtje: “Në përgjigje të kërkeses suaj të ardhur nepermjet sistemi elektronik te APP-se më datë 18.09.2023 ku kërkohen shpjegime ne lidhje me ofertën e paraqitur nga shoqëria "M.Lezha" shpk për procedurën me objekt "Blerje pajisje mobilerie, Shkolla fillore "Myrteza Sala" Bilisht, Devoll", REF-79080-09- 06-2023 e zhvilluar me dt. 18.09.2023 nga institucioni Juaj po ju informojmë Kompania M.LEZHA Shpk, e krijuar qe ne vitin 1996 është lider në biznesin e prodhimit të mobiljeve dhe renditet ndër kompanitë kryesore në Shqipëri. Ajo ka nje eksperience te gjere ne fushen e mobilimit, me nje aktivitet te shtrire ne te gjithë shqiperine.

Gjate experiences se saje shume vjecare kompania ka mbuluar te gjitha sferat e fushes se mobilimit si mobilimi i banesave si më poshtë: dhe apartamenteve, konvikteve per cikle te ndryshme, banesave sociale, kopshte dhe cerdhe, shkolla te te gjitha cikleve dhe universitete, zyra te ndryshme, ambiente te gjykatave dhe prokurorive etj.

Kompania e ushtron aktivitetin e saj ne ambiente te medha te ndodhura ne zonen industriale te Shkodres. Ambientet e kompanise kane te nderthurur fabriken me repartet e saje perkatese: prodhimi, montimi, lyerja, magazinimi; me ambientet e zyrave. Organizimi I ketyre ambienteve ne menyren e duhur dhe pajisja me ndricim, ajrim te mjaftueshem dhe teknologji moderne ka krijuar mjaft lehtesira ne procesin e prodhimit duke rritur eficensen dhe njekohesisht ulur kostot e prodhimit. Dizejnimi dhe krijimi I produkteve gjithnje e me shume ergonomike, te thjeshta per perdorim ka ndikuar gjeresisht ne uljen e kostove operacionale dhe te prodhimit.

Gjithashtu nje nga synimet primare te kompanise ka qene kualifikimi dhe jetegjatesia ne pune e punonjesve, cka ka sjelle nje staf te kualifikuar, te pergjegjshem e i"novator.

Per sa I perket lendes se pare te perdorur ne prodhim, eshte synuar gjithmone gjetja e cmimeve sa me konkurruese .

Me poshte po shpjegojme kostot e artikujve te kesaj procedure.....:”

III.3.4. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]

III.3.5. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.3.6. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “M.Lezha” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 2.833.900 lekë pa TVSH , në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi

duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t'i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.3.7.Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “M.Lezha” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe

rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “M.Lezha” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues në seksionin “Kërkesa” të Sistemit të prokurimeve elektronike drejtuar autoritetit kontraktor, shkrësën e datës 20.09.2023 me objekt “Kthim përgjigje në lidhje me ofertën anomalisht të ulët të shoqërisë M.Lezha shpk”. Në përmbajtje të kësaj shkrese, përveç përgjigjes së përshkruar në pikën III.3.3. të këtij vendimi, operatori ekonomik “M.Lezha”SHPK ka vendosur nga një tabelë për çdo artikull objekt prokurimi, në të cilën ka paraqitur koston totale të çdo artikulli, por pa dhënë asnjë detaj tjetër se si ka dalë në këtë kosto.

KPP gjykon se operatori ekonomik “M.Lezha”SHPK në përgjigjen e dhënë, nuk ka paraqitur prova shkresore për elementet e ofertës sikurse është kërkuar nga autoritetit kontraktor e konkretisht nuk ka paraqitur asnjë dokument për zbërthimin e anës ekonomike e të metodës së ndërtimit si një nga komponentët e rëndësishëm të nenit 93 të LPP. Referuar argumentimit të ofertës anomalisht të ulët, OE “M.Lezha” SHPK në asnjë pikë nuk i referohet përmbushjes së gërmës a) të nenit 93 të LPP ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së koston për të gjitha elementet. Operatori ekonomik ka detyrimin të paraqesë të detajuar analizën e koston së zërave të kërkuara në mënyrë analitike, pra të argumentojë me prova dhe fakte si të justifikojë çmimin e ofertuar për çdo zë.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se nga ana e OE “M.Lezha” SHPK nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion provues mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, duke mos përmbushur kështu një nga kushtet e rëndësishme kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së. KPP gjykon, se ankimuesi nuk ka paraqitur analizë-kostoje të detajuar që të argumentojë kushtet apo elementet, pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër, KPP gjykon, se shpjegimi i paraqitur me shkrësën e datës 20.09.2023 nga OE “M.Lezha”, SHPK, në SPE, për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nuk përbën prova të mjaftueshme në funksion të argumentimit të: anës ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, apo origjinaliteti i shërbimit të propozuar. Argumentimi i dhënë nga ofertuesi në rastin konkret nuk krijon bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Klame” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin

e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Klame” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-79080-09-06-2023 me objekt: “Blerje pajisje mobilerie, Shkolla fillore ”Myrteza Sala” Bilisht, Devoll”, me fond limit 4,298,177 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Klame” SHPK për skualifikimin e operatorëve ekonomikë ”Murati-D” SHPK e “M.Lezha” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë ”Murati-D” SHPK e “M.Lezha” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Klame” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri